DUKE LEXUAR SIMBOLIKAT E FJALËVE TË H. SABRI KOÇIT, GAZALIUT DHE KEFTAROS...

NJË LUTJE TE VARRI I HOXHËS HAFIZ IBRAHIM REPISHTI (1882-1943)...

TRASHËGIMIA E FEMRËS DHE ÇËSHTJA E BARAZISË (2)

Viti XV - Nr. 11 (177), Nëntor, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme Informative - Fetare Kulturore - Edukative

"Kemi pasë frikë t'kujtojmë se ka Barjam dhe Ramazan! Kemi pasë frikë se ka Netë t'Mira e të tjera! Kjo qe nji provë! Qe nji provë e fortë për me vërtetue sesa e thellë asht dashtunija e Zotit tek krijesat e Veta!"

Hafiz Sabri Koçi

"EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)"

Kjo ndihmë e madhe prej Zotit (xh.sh) qe një parapërgatitje për ardhjen e Muhammedit në këtë botë. Kjo ia shton nderin Qabes së madhërueshme, ia lartëson vlerën, rrit lidhjet e njerëzve me të, forcon dashurinë arabe për të e për banorët e saj.

Bekimet pasuan një pas një. Me lindjen e tij,

DUKE LEXUAR SIMBOLIKAT E FJALËVE TË HAFIZ SABRI KOÇIT, GAZALIUT DHE KEFTAROS...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Neve kemi kenë t'penguem për pesëdhjetë vjet me radhë! Kemi pasë frikë t'themi se ka Zot! Kemi pasë frikë t'adhurojmë të Madhin Zot! Kemi pasë frikë t'kujtojmë se ka Barjam dhe Ramazan! Kemi pasë frikë se ka Netë t'Mira e të tjera!

Kjo qe nji provë! Qe nji provë e fortë për me vërtetue sesa e thellë asht dashtunija e Zotit tek krijesat e Veta!"

Këto fjalë i dëgjova mbrëmë në një fragment, shkëputur nga një prej hytbeve të pakta të regjistruara nga predikimi i Hafiz Sabri Koçit... Ka hyrë në histori ky burrë, edhe pse akoma mendoj dhe besoj se sirret e dritësisë së tij kanë ngelur peng diku, sa larg, aq afër...



HAFIZ SABRI KOÇI (1921-2004)

Hafizi, të cilin kam pasur fatin e mirë ta dëgjoj sa e sa herë, por edhe ta intervistoj e të rri me të vetëm për vetëm, edhe asokohe, kur fare pak kush e vizitonte në shtëpinë e tij në kryeqytet, (për shkak të moshës së thyer dhe lodhjes), vinte nga një shkollë, zinxhiri i së cilës fillonte në Shkodrën e vitit 1952, para duarve të H. Muhamed Bekteshit dhe përfundonte në Medinen e Ndriçuar, në ditët më të bukura dhe më të shtrenjta të historisë së njerëzimit... (Nuk e di se a u trashëgua më tej brezit të Hafizit, a jo, ai zinxhir, por di me siguri se një grupi prej nesh, fëmijët e Hafizit, në moshë, na u dha rasti të kapemi pas një cope të vetme të mbetur prej tij, duke u bërë shpirtërisht pjesë e tij, me plot krenari dhe nder, në gjurmët e traditës sonë dhe bardhësisë së saj..!)

Tash që po afron data e shënuar e përkujtimit të rihapjes së xhamisë së parë në Shqipëri, pas dekadave histerie dhe fortunash të pashembullta ateo-komuniste, bashkë me të cilën datë, edhe Hafiz Sabri Koçi, edhe vetë dita e 16 nëntorit 1990, edhe Shkodra, hynë se bashku në historinë e lavdisë së shpirtit të kombit shqiptar; këto fjalë të thëna prej Hirësisë së Tij marrin një vlerë e një peshë të madhe, para të cilave na takon të ndalemi në respekt, por me plot meditim e gatishmëri reflektimi!

Fjalët e Hafiz Sabri Koçit, në kontekstet e realiteteve të muslimanëve shqiptarë sot, më risjellin në vëmendje eruditin dhe mendimtarin e shquar egjiptian, Shejkh Muhammed El-Gazali, bashkëkohës i Kryemyftiut tonë rahmetli.

Gazaliu i kohës sonë, shkruan: "Ka



SHEJKH MUHAMED EL-GAZALI (1917-1996)

një sulm të madh që i drejtohet fesë, pas shpine! ... Rruga që kanë vizatuar për muslimanët, është largimi dhe distancimi nga feja e tyre dhe rregullat e saj, eliminimi i simboleve dhe emblemave! Kërkohet që të angazhuarit në shoqërinë islame, të jenë një model, pa ngjyrë, pa shije dhe pa erë. Një lloj, që nuk njihet për nga identiteti dhe ngjyresa fetare dhe ajo e moralit...!" - *(Shejkh Muhammed El-Gazali, "El-gazvuth-thekafi jemteddu fi feragina", botimi i parë, Kajro, 1998, f. 126)*

Siç vihet re, ka një emërues të përbashkët në dy citimet e lartshënuara; lufta kundër Islamit dhe muslimanëve! Frikësimi dhe mjegulli i rrugëtimit solid drejt përgjigjes së thirrjes hyjnore: "O ju që keni besuar, hyni të gjithë në rrugët e paqtimit (në Islam) dhe mos ndiqni hapat e shejtanit..." – (El-Bekare: 2018)

Dhe, teksa lexojmë të shkuarën

> **"Ne duhet ta lexojmë Kur'anin si udhërrëfim hyjnor, si urdhëresa të shenjta që na drejtohen, për t'i kuptuar dhe praktikuar, për dije dhe zbatim të menjëhershëm në jetë! Kështu lexohet Kur'ani!"**

e shekujve të afërt dhe të sotmen, vërejmë se format e kësaj lufte janë të llojllojshme: diku politikisht, diku kulturalisht, diku ushtarakisht, diku ekonomikisht, diku historikisht, diku me zjarr e diku me mëndafsh..!? (Më e keqja është kur në thelb të lëvizjeve islame mbillen fidanë hibridë, pa ngjyrë, pa aromë, pa shpirt, pa puls, pa nerv, robotikë, që përballë krijuesve të tyre qëndrojnë si ushtarë të bindur, pa arsye e logjikë! Këta, të përkrahur edhe nga politika të caktuara, vegjetojnë të qetë, sado vazhdojnë të kryejnë funksionet për të cilat janë ku janë, si propagandues të një Islami "pa yndyrë"! Është sprovuar jo pak bota e jonë islame nga këto modele, që janë përhapur kudo në trupin e ymetit si tumore vdekjeprurëse!?)

Sot, në prag të përvjetorit të 27-të të rikujtimit të simbolikës së Hafiz Sabri Koçit dhe 16 nëntorit 1990, ne si muslimanë shqiptarë e kemi për borxh moral ndaj fesë dhe kombit, ndaj hoxhallarëve të shkuar, (një pjesë e mirë e të cilëve, ende nuk janë studiuar e vlerësuar si e sa duhet për çfarë ishin e çfarë dhanë, sikurse një pjesë tjetër, të cilët janë prezantuar sipas interpretimeve dhe analizave të ngushta dhe cunge, në duar laikësh me matricë islame krahësh!?), ndaj traditave, ndaj shekujve të lavdishëm të Hilafetit tonë, ndaj të sotmes së fëmijëve dhe rinisë sonë, si dhe ndaj të ardhmes; të

ndalemi e të shohim se ku jemi dhe ku po shkojmë?!

SHEJKH AHMED KEFTARO (1912-2004)

Lexova sonte një citim largpamës të Kryemyfiut sirian, Hoxhës, Shejkh Ahmed Keftaro, kur thoshte në një prej ligjëratave të tij: "A e lexojmë ne sot, Kur'anin, si besimtarë, a si zullumqarë? Leximi i besimtarëve është leximi për mësim dhe veprim, ndërsa ai i zullumqarëve është thjeshtë për lexim sipërfaqësor, për analiza gramatikore, për rregulla texhvidi, për idgamin dhe kalkalenë... Prandaj, ne duhet ta lexojmë Kur'anin si udhërrëfim hyjnor, si urdhëresa të shenjta që na drejtohen, për t'i kuptuar dhe praktikuar, për dije dhe zbatim të menjëhershëm në jetë! Kështu lexohet Kur'ani!"

Me fjalë të tjera, sot, pas 27 vitesh nga ajo thirrje e shtrenjtë e Hafiz Sabri Koçit, thirrje që zgjoi nga gjumi letargjik Shkodrën, Rozafën, tokën e topitur shqiptare dhe vullnetet e plogështa, të vrara moralisht e të sakatosura deri në mpirje, e kemi për detyrë karshi kësaj date të lavdishme historike, që shënon Ndryshimin dhe Përmbytjen e sprovës, të pyesim: Ku jemi dhe ku po shkojmë?

Sa peshon sot, emri musliman në realitetet shqiptare? Sa peshojnë muslimanët me Islamin e tyre të kthjellët qelibar në jetën e përditshme shqiptare, në parlament, në politikë, në ekonomi, në drejtësi, në media, në kulturë, në kufijtë e paprekshëm të frymës së harmonisë kombëtare, që përkundet në djepin e ajeteve kur'anore, haditheve pejgamberike dhe traditave shekullore të pikave të shëndosha të referimit tonë përgjatë shekujve e në çdo fushë të jetës, ku individi musliman është i thirrur të prodhojë mirësi, mbështetur në pragun e perfeksionit, dashnisë për vëllanë e tij njeri dhe vullnetin për ta ndërtuar jetën me Dritën e udhëzimit?!

Ku është e drejta dhe respektimi i kufijve të patolerueshëm sot, teksa as një as dy, Islami dhe muslimanët nëpërkëmben, shkelen e etiketohen mjerisht me llagepe, që botërisht dihet se nuk u përkasin!?

Ku përpëliten sot, e 27 vite të shkuara në tymnajat e hirta të premtimeve demagoge, pronat vakëf, e drejta e plotë e shfrytëzimit dhe përfitimit legjitim prej tyre në rrugën e rimëkëmbjes së merituar të aktivitetit dinamik të Thirrjes Islame tek ne, ndërtimi i institucioneve të domosdoshme, (jo të izoluara e sektare), për edukimin e rinisë sonë, (që përballet mjerisht me një bombardim kulturor e shpirtëror), larg ndikimeve kapriçioze që fryjnë herë nga lindja e herë nga perëndimi, zhvillimi i arsimit fetar mbi bazat e traditës, jo veshjes me petkun e përulësisë fallce e ndjenjës së inferioritetit, përfitimi nga shkollat e botës islame, nëpërmjet të diplomuarve të urtë në mesin tonë, për ndërtimin e një strukture të fortë e solide, që nuk mund të lëkundet përpara sfidave e përballjeve dinake, nxitja e zhvillimit ekonomik, organizimi përtej dyerve të ngushta e të mbyllura të xhamive plot dritë, çlirimi nga ligjërimet folklorike e të mbushura me mediokritete, plot artificializëm, sidomos kur përmenden terma të tilla, si: "kombi", "toleranca", "harmonia", që dëgjohen vend e pa vend nga shtatanikë thatimë mendërisht e intelektualisht, edhe në mesin tonë, duke ia humbur këtyre fjalëve të paqta, bukurinë e natyrshme, forcën e kumtimit, madhështinë e simbolit!?

Ku jemi sot, teksa poshtë e përpjetë, duket sikur na "udhëzojnë", si në heshtje të pakuptueshme drejt pasivitetit dhe inferioritetit në mendim, në arsyetim e ligjërim, në veprim të shëndoshë e qëndrime krenare legjitime, në përpjekjet për ndërtimin e urave solide të dijes, mëshirës, harmonisë e dinjitetit, si pjesë e shëndoshë e aspak e anashkalueshme e shoqërisë ku jetojmë!?

Duket, se përtej horizonteve të ngushta të këtij labirinthi, dëgjohen zhurmat e kërcimit të shthurur të dikujt që deliron në vetëposhtërim, teksa dëgjon vargjet e poetit të vjetër, izolueshëm nga bota dhe drita e së ardhmes: "Më jep të pij ca gota dhe më këndo për kujtimin e Sulejmës, bjeri kemanes dhe thurr tinguj"..!?

Është kohë zgjimi nga dehja dhe duhmat mbytëse të rutinave pa dritë simbolesh dhe thirrje heronjsh, si ato që përgatitemi të përkujtojmë pas pak ditësh!

Shkodër, më 14 nëntor 2017

Nga Enes ibn Maliku (r.a) transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Dijetarët në tokë janë si shembulli i yjeve, me të cilët orientohesh në tokë dhe në det. Po qe se yjet shuhen, njerëzit mund ta humbasin drejtimin".

(transmetuar nga Ahmedi)

IMAMI QË KËNDONTE...!

"Vetja ime, nuk ka qenë e as nuk është epshi -
- Ji i përkushtuar ndaj Zotit! Frikësoju dhe ruaju Atij!"

Shejkh Muhamed El-Gazali

Nuk njoh asnjë prej dijetarëve fukaha (juristë) që të ketë refuzuar këngën fetare, prandaj kush është ai që urren nxitësit e dashurisë për Allahun, madhërimin e emrave dhe falënderimin për begatitë e Tij? Dhe, kush e urren nxitimin drejt Tij, të qamurit për neglizhencën dhe humbjen e hakut të Tij?

Dijetarët (fukahatë) kanë refuzuar arë që quhet "rrethet e dhikrit", në të cilat shtohen zhurmat dhe britmat, fishkëllimat e zërat e ndryshëm, vallet e kërcimet, të cilat në të vërtetë janë gjendje harrese dhe jo gjendje kujtese (dhikri), e rrethe kërcimesh të shëmtuara, të mbushura me bidate dhe legjenda, që nuk i pranon mendja.

Në trashëgiminë tonë të vyer ka gjëra që meritojnë të promovohen e të gjallërohen. Sufisti Ebu El-Hasen El-Kurafi tregon nga El-Hasen se, disa njerëz shkuan te Umer ibnul-Hatabi (r.a) dhe i thanë: O prijësi i besimtarëve, kemi një imam, që kur mbaron faljen e namazit fillon e këndon! Këtë ngjarje e transmeton Imam Shatibiu në volumin e parë të librit të tij "El-I'tisam".

Umeri tha: Kush është ai?

I treguan për kë bëhet fjalë.

Tha: Ngrihuni të shkojmë tek ai, sepse nëse ne shkojmë atje, mendon se e kemi përgjuar punën e tij.

Shikoni respektimin e të drejtave të njeriut dhe ruajtjen e nderit të tyre. Umeri me disa shokë të Pejgamberit (a.s) u nisën e shkuan tek ai, ndërkohë që ai ndodhej në xhami! Sapo e pa Umerin, u ngrit për ta pritur dhe i tha: O prijësi i besimtarëve, çfarë halli ke? Dhe, çfarë të ka sjellë këtu? Nëse është nevojë e jona, ne na takon më tepër të vijmë tek ty, e nëse është nevojë e jotja, atëherë e meriton më shumë të madhërohet, kalifi i Resulullahut (a.s).

Umeri i tha: Mjer për ty! Më ka ardhur një lajm i keq për ty.

Imami: Po, çfarë është ai, o prijësi i besimtarëve?

Umeri: A tallesh në ibadetin tënd?

Imami: Jo, o prijësi i besimtarëve, por ajo është një kështillë që ia drejtoj vetes sime.

Umeri: Thuaje, sepse nëse është fjalë e mirë, e them edhe unë me ty! E, nëse është e shëmtuar, të ndaloj prej saj.

Imami:

Zemra, e sa herë që e qortoj - për largimin, kërkon të më lodhë.

Kohën, nuk e shoh, veçse duke luajtur - në vazhdimësinë e saj..ajo po më mundon.

O shok i keq, çfarë është kjo papjekuri - jeta iku kështu në lojë.

Rinia më shkoi dhe iku - përpara se ta mbaroj, u plak.

Nuk shpresoj pas saj, veçse të tretem - thinjat ma ngushtuan qëllimin tim.

Mjer për veten, që nuk e shoh kurrë - të jetë mirë, e as në edukim.

Vetja ime, nuk ka qenë e as nuk është epshi - Ji i përkushtuar ndaj Zotit! Frikësoju dhe ruaju Atij!

Umeri:

"Vetja ime, nuk ka qenë e as nuk është epshi - Ji i përkushtuar ndaj Zotit! Frikësoju dhe ruaju Atij!"

Për këtë, le të këndojë, kush dëshiron të këndojë..

Unë i dua ndjenjat e sinqerta dhe tingujt që frymëzojnë të mirën, shërbyese të së vërtetës! Kush refuzon, ai le të pohojë për veten e tij, por të mos i kundërshtojë të tjerët në emër të fesë.

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja



Mesazhi i Myftiut të Shkodrës në 27 vjetorin e rilejimit të fesë

Të nderuar të pranishëm,

Sa herë vjen data 16 nëntor, ne si bashkësi fetare, përfshihemi në emocione që na lidhin me një ngjarje të shënuar, ndër më të spikaturat e shekullit për ne dhe mbarë kombin tonë!

Një ngjarje që lidhet me kujtimin e së shkuarës jo fort të largët, gati-gati të pabesueshme, të imponimit me dhunë të ateizmit, si dhe kujtimin e së shkuarës 27 vjeçare, gati-gati në kufijtë e së shenjtës, kur Drita e Udhëzimit triumfoi mbi errësirën e femohimit dhe afetarizmit.

Sot, teksa besojmë të lirë dhe praktikojmë të pacënuar ritualet e fesë dhe besimit tonë, kuptojmë se sa e rëndësishme është në një shoqëri dhe për të, respektimi dhe mbrojtja e fesë dhe besimit, sepse ato qëndrojnë në themelet e zhvillimit dhe përparimit kombëtar e njerëzor!

I rikthehem herë pas here fjalimit historik të Hafiz Sabri Koçit, të xhumanë e shtrenjtë të 16 nëntorit 1990. Përherë, impulse pozitive që të shtyjnë përpara gjej në atë jehonë shpirti të një fetari të ditur, që ishte sprovuar e dhunuar për fenë e tij, sa veç Zoti e di!

Atë ditë, ai ishte modeli i prijësit islam e kombëtar, në një moment në kufijtë e delirit, por që gjithsesi, mbeti dëshmi e këtij Islami të pastër, që trashëgojmë nga burimet e kulluara të Fesë sonë; Islam i së ardhmes, faljes, vëllazërisë, harmonisë ndërnjerëzore, ngritjes pas pabesisë,

aftësisë për të mbledhur forcat drejt rizgjimit dhe rimëkëmbjes, me bekimet dhe mbarësinë e Zotit!

Shoqëria e jonë shqiptare sot, e ka të domosdoshme të hedhë vështrimet nga ajo që na kalpoi si komb dhe e sotmja. Secili prej nesh e ka për detyrë fetare dhe kombëtare të bëjë më të mirën për t'u kthyer nga Zoti, nga besimi dhe organizimi i jetës mbi atë që na frymëzon ndjenja e besimit, dashnisë dhe frikës së Zotit në jetë.

Fenomene të frikshme që lidhen me botën e femohimit, shthurjes e degradimit moral, politik, ekonomik e që ndikojnë në thelb të avenirit të shoqërisë, e kemi për detyrë t'i shohim ballë për ballë, në rrugëtimet tona drejt ndërtimit të vlerave dhe distancimit nga ekstremizmi, dhuna, terrori, shkelja e të drejtave dhe mosrespektimi i tyre, korrupsioni dhe veset, përhapja e afetarizmit dhe e rrugëve që shpien drejt tij.

Si sot, para 27 vjetësh, Hafiz Sabri Koçi, dëshmonte: "Iu hapën portat zemrave, që të njohin, të dashurojnë, të respektojnë më të Afërmin e tyre, i Cili është më afër te njeriu sesa ai te vetvetja: Zotin! Lavdi të Madhit Zot, që e ruajti dashurinë e Tij në zemrat tona e nuk na përbuzi... aq më tepër në zemrat e kësaj rinie që sapo del në jetë pa qenë në kontakt me asgjë, ia ndezi dritën e dashurisë së Tij në zemër e në shpirt!"

Pikërisht për këtë bekim kemi nevojë akoma sot, që rinia shqiptare dhe mbarë njerëzimi, të kthehen nga dyert e pendimit, faljes, mëshirës e paqes së brendshme me Zotin e gjithësisë!

All-llahu e begatoftë rininë e Shkodrës, rininë shqiptare dhe mbarë njerëzimin, me Dritën e dashnisë së Tij!

Rahmet pastë Hafiz Sabri Koçi dhe krejt ata burra të urtë e të guximshëm që u mblodhën përreth tij, në një rrugë të gjatë e plot vështirësi, që pat si kredo Besimin në Një Zot dhe mbështetjen në Premtimin e Tij: "Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe ata që besuan, në jetën e kësaj bote dhe në ditën e prezantimit të dëshmive!" – (Kur'ani, Gafir: 51)

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, 16 nëntor 2017

MYFTIU: "DHIKRI, ÇELËS I SEKRETEVE TË MBARËSISË!"

Me ftesë të drejtorit të konviktit të djemve, pranë Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Gezim Dungaj, mbrëmjen e së martës, më 14 nëntor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti një ligjëratë para medresistëve të pranishëm.

Në ligjëratën e tij, Myftiu u ndal tek sfida e virtyteve dhe moralit në realitetet e të rinjve të sotëm shqiptar dhe domosdoshmëria e kuptimit të vlerave të identitetit islam, që qëndron në themel të identitetit kombëtar, në këtë kontekst.

Myftiu tha se brumosja me besën, ruajtjen e amanetit, ruajtjen e tabanit familjar të mëkuar me dashninë e All-llahut dhe atë të dërguarit të Tij, mbeten një qëllim fisnik në rrugën e mbrojtjes së të sotmes nga kërcënimi i hutimit,

shthurrjes morale, humbjes së kohës, propagandave të shumta drejt afetarizmit dhe të jetuarit pa besim.

Gjatë ligjëratës së tij, Myftiu theksoi se veshja me virtytet e fesë dhe besimit në Islam plotësohet me vullnetin e muslimanit për të mos u ndarë nga dhikri i vazhdueshëm i All-llahut, që është çelësi i sekreteve të mbarësisë në jetën e individit.

SHTATË ARSYE PËR FALJEN E NAMAZIT ME XHEMAT NË XHAMI

Hfz. Mehas Alia, *imam*
Xhamia El-Hidaje, St. Gallen, Zvicër

Sikur namazi, ashtu edhe xhemati, është një nga detyrimet e secilit musliman. Ja ku janë disa arsye se pse duhet vazhdimisht që të theksohet rëndësia e faljes së namazit me xhemat, e sidomos në xhami:

1. Falja e namazit me xhemat në xhami tregon për respektin dhe përulshmërinë ndaj All-llahut (xh.sh), si dhe ndaj urdhërit të Tij, i cili në Kur'anin Famëlartë ka thënë: "Fale namazin, jepe zekatin dhe falu sëbashku me ata që falen." - (El-Bekare, 43)

2. Me faljen e namazeve në xhami e ndjekim dhe e pasojmë rrugën e Muhammedit (a.s), kurse kjo është garanci për të na dashur All-llahu (xh. sh). All-llahu (xh.sh) thotë: "Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë më ndiqni mua, kështu që All-llahu do të ju dojë juve dhe ka për t'ua falur gjunahet." - (Ali Imran, 31).

3. Falja e namazit me xhemat është shumë i vlefshëm se sa namazi i falur vetëm. I Dërguari i All-llahut (a.s) thotë: "Namazi i falur me xhemat është më i vlefshëm 27 herë më shumë se sa namazi i falur vetëm." - (Buhariu).

4. Çdo herë kur njeriu shkon në xhami për të falur namazin me xhemat, All-llahu (xh.sh) ia përgatit vendin e tij në xhennet. Muhammedi (a.s), ka thënë: "Sa herë që besimtari shkon në xhami, All-llahu (xh.sh) për këtë i përgatit një vend në Xhennet." - (Buhariu)

5. Zoti ynë i gëzohet vajtjes sonë në xhami dhe faljes së namazit me xhemat. Muhammedi (a.s), ka thënë: "Kur dikush prej jush e plotëson mirë abdesin dhe pastaj shkon në xhami për ta falë namazin, All-llahu (xh.sh) i gëzohet kësaj vizite, sikur që gëzohen të afërmit kur e shohin ndonjë familjar të vetin që u ka munguar." - (Ibn Maxheh).

6. Çdo hap që bëhet në drejtim të xhamisë ka rëndësi dhe vlerë të veçantë. I Dërguari i All-llahut (a.s) ka thënë: "Çdo njeri që niset për në xhami për të falë namaz, në secilin hap i fshihet një gjynah dhe i shkruhet një sevap, dhe kjo i shkruhet si ndaj vajtjes në xhami, ashtu edhe ndaj kthimit." - (Ahmedi).

7. Muhammedi (a.s), nuk i ka lejuar as edhe një të verbëri që ta lëshojë namazin me xhemat. Thuhet se një njeri i verbër kishte kërkuar nga Pejgamberi (a.s) për t'ia lejuar mosardhjen në xhami për namaz, duke u arsyetuar se nuk ka dikë, i cili do të mund ta ndihmonte gjatë rrugës, madje duke i shtuar edhe disa arsye të tjera. Pejgamberi (a.s), e kishte pyetur: A e dëgjon ezanin? Po – ishte përgjigjur plaku. Atëherë Pejgamberi (a.s) i kishte thënë: Atëherë, përgjigju ezanit!" (Buhariu).

"Përgjigju ezanit", don të thotë: Eja në xhami!

Le t'i përgjigjemi pra All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe le ta falim namazin me xhemat, me sa mundësi që do të kemi. Falja e pesë kohëve të namazeve duhet të jetë derti ynë dhe i familjes, bashkëshortes, fëmijëve, prindërve, farefisit, miqve dhe shokëve. Derti ynë duhet të jetë edhe namazi me xhemat.

"Kush e ruan xhematin, e ka ruajtur xhennetin" – thoshte Muhammedi (a.s).

KUR MUND TË LËSHOHET NAMAZI ME XHEMAT?

Mungesa në faljen e namazit me xhemat mund të arsyetohet me rastet vijuese:

– Për shkak të temperaturës së lartë ose të ftohtit;

– Nëse bie shumë shi, borë ose breshër; nëse është shumë lagështi ose nata shumë e errët;

– Për shkak të sëmundjes së rëndë;

– Nëse njeriu është pa këmbë ose me shkallë të lartë të invaliditetit të këmbës;

– Nëse personi është tepër i moshuar;

– Nëse gjatë rrugës mund të kërcënohet pasuria dhe jeta e besimtarit;

– Nëse njeriu është mysafir – udhëtar;

– Nëse është i zënë me studimin e shkencave fetare; dhe

– Nëse vuan nga ndonjë sëmundje ngjitëse ose nëse frikësohet se në shoqëri do të takohet me ndonjë person prej të cilit mund t'i ngjitet sëmundje.

NJË LUTJE TE VARRI I HOXHËS HAFIZ IBRAHIM REPISHTI (1882-1943)...

Përveçse një imam i respektuar në lagjen e tij, Dudas, (ku shërbeu, sidomos për afro 20 vitet e fundit të jetës së tij), ai mbante në shpirtin e tij të pashuar pishtarin e të atit, Haxhi Jusuf Repishti, nënshkrues i Memorandumit të 13 qershorit 1878, dërguar Kongresit të Berlinit për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Herë pas here, teksa vizitoj varrezat e qytetit tim, ndalem në lutje para varreve të hoxhallarëve të shkuar dhe njerëzve të urtë, që tashmë janë kthyer në kujtim, duke i shtuar Shkodërloces varfëri, mbi varfërinë që e ka kapluar...

Pranë tyre, nuk është e vështirë të përfshihesh nga energjia pozitive që përhap kudo përmendja e tyre, kujtimi, meditimi e lutja. Kështu më ndodhi edhe sot, pranë Hoxhës së shquar shkodran, Hafiz Ibrahim Repishti...

Zotërinë e tij e deshta fillimisht, nëpërmjet leximeve të kujtimeve të rreshtuara nga i biri, intelektuali dhe eruditi i shquar, prof. Sami Repishti. (Ishte një koinçidencë e pallogaritur, që sot, nëpërmjet shtypit të përditshëm, lexova një shkrim të burrit të urtë shkodran, që herë pas here, vazhdon të dërgojë nga larg analizat e tij, që lexohen me një frymë dhe me shumë kënaqësi. Janë shkrime dhe analiza të dikujt që i dhemb e sotmja e kombit dhe e vendlindjes, që mendon pandërprerë për to, edhe si një amanet i shenjtë i tabanit familjar..!)

Hafiz Ibrahim Repishti mbetet në heshtjen e tij, një model i përkryer për hoxhallarët dhe imamët e kohës sonë dhe përtej saj.

Përveçse një imam i respektuar në lagjen e tij, Dudas, (ku shërbeu, sidomos për afro 20 vitet e fundit të jetës së tij), ai mbante në shpirtin e tij të pashuar pishtarin e të atit, Haxhi Jusuf Repishti, nënshkrues i Memorandumit të 13 qershorit 1878, dërguar Kongresit të Berlinit për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Për këtë, nuk duhet të habitemi kur lexojmë, se për mbrojtjen e Shkodrës nga serbo-malazezët, nën drejtimin e komandantit Hasan Riza Pasha, edhe Hafiz Ibrahim Repishti, do të dilte vullnetar për mbrojtjen e shenjtërisë së tokës, në atë periudhë të vështirë, tetor 1912 - prill 1913.

Edhe ai, si shumë hoxhallarë të nderuar të Shkodrës, (përmend këtu: H. Abaz Golemi, H. Halil Gavoçi, H. Sulejman Gavoçi, H. Musa Dërguti, H. Sheh Ali Kruja etj.), ishin pjesë e çetave burrnore për mbrojtjen e Shkodrës! Ishin dhe mbetën burra nderi, heronj kombi, edukatorë të urtë!

HAFIZ IBRAHIM REPISHTI (1882-1943)

Sipas Hamdi Bushatit, në veprën e tij "Shkodra dhe motet", Hafiz Ibrahim Repishti ishte pjesë e zinxhirit të artë dituror, që kishte për Mësues dhe Edukator, të urtin Hafiz Halid Bushati. Pas këtij pragu të rëndësishëm, në vitin 1907 ai vazhdoi studimet në kryeqendrën e Hilafetit tonë, Stamboll, ku u diplomua në shkencat islame.

Pas largimit të malazezëve nga Shkodra, më 8 maj 1913, (duke lënë pas edhe shkrumbimin e 250 dyqaneve të pazarit të Madh, siç shkruan vetë Hafizi në ditarin e tij), ai nisi të përfshihej në jetën politike të vendit, që kulmoi me zgjedhjen e tij si përfaqësues i Shkodrës, anëtar i Asamblesë Kushtetuese. (Për të shënohet, se në Parlamentin e kohës ka kryer funksionet e Nënkryetarit të Komisionit Parlamentar për jurisprudencë dhe të Komisionit Parlamentar për arsimin).

Episodet e jetës së Hafiz Ibrahim Repishtit janë të shumtë dhe të ftojnë t'i lexosh, për të kuptuar shpirtin e traditës sonë islame qytetare, tabanin e trashëgimisë së pastër kombëtare, pikënisjet për të ardhmen e mbetur peng në duart e të paditurve, të nënshtruarve para modeleve hibride e thuajse të imponuara gjithandej, si një kamuflazh i hirtë që mban mendjen dhe shpirtin të mpirë, të heshtur, të vdekur klinikisht.., thjeshtë në vegjetim!?

Ditët e pushtimit të egër fashist, nuk kursyen as familjen e Hoxhës së ditur, që personalisht kishte refuzuar propozimin e italianëve për t'u bërë Kryemyfti i Shkodrës.

"Nji mesnatë, nji bastisje e papritun e shtëpisë nga policia fashiste tronditi gjumin e familjes sonë. Të rreshtuem me shpinë për mur, prind e fëmijë ndoqën me frikë në zemër lëvizjet e randa e të zhurmshme, si dhe shamjet e papushim të agjentëve të armatosun që silleshin poshtë e nalt tue kërkue në çdo vrimë të shtëpisë diçka që nuk e gjejshin... Nji oficer mori babën prej krahu me forcë, e me nji të shtyme e vuni në nji dhomë tjetër..."-, rrëfen prof. Sami Repishti në librin e tij: "Pika loti", botuar në vendlindje, në vitin 1997.

Siç duket, në çdo kohë, fashizmi dhe terrori, injoranca dhe islamofobia, dhuna dhe e keqja, bëhen një, nuk kanë shenjtëri, nuk kanë respekt për dijen, familjen, tabanin, trashëgiminë, rrënjët...

Nga ana tjetër, këta të fundit kanë triumfuar përherë përballë duhmave të të mallkuarit, që herë pas here, kohë pas kohe dhe situatë pas situate përhapen në atmosferën tonë, duke helmuar, sidomos ata që kanë imunitet të dobët, që para së keqes frikësohen e janë të gatshëm të bëhen argat i saj për hiç gjë...

Rahmet pastë Hoxha Ibrahim Repishti dhe koha e tij plot episode për të mos u harruar në neglizhencë.

Shembulli i tij u lexoftë larg ndikimeve sektare dhe diktimeve mjerane të kohës sonë..!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 16 tetor 2017

EDUKATA FETARE E FËMIJËVE NË FAMILJE

Besim Barbullushi, *Bursa - Turqi*

Sado të mira dhe funksionare të jenë strukturat arsimore dhe edukative, nuk mund ta zëvendësojnë rrethin familjar në procesin e edukimit të fëmijës.

Periudha më kritike për formimin e një fëmije është periudha parashkollore, ku pjesën më të madhe e kalon me familjen e tij dhe kjo luan një rol të rëndësishëm në "edukatën fetare" ose "arsimimin fetar".

Në botën e një fëmije kemi të bëjmë me dy ambiente ose dy perceptime të asaj që ai sheh; me rrethin e brendshëm, ku fëmija në këtë ambient përfshin më të dashurit dhe më të besueshmit, dhe me rrethin e jashtëm. Roli i ambientit ose rrethit të brendshëm në këtë rast është fitimi i ndjenjave të fëmijës kundrejt asaj që ai e quan të huaj dhe roli më i madh në këtë çështje është i familjes.

Në këtë periudhë fëmija fiton 3 vlera sjelljesh; besimin, mendimin dhe sjelljen, ose reagimin. Nëse e shohim në prizmin islam, Allahu çdo njeriu, këto 3 vlera ia ka krijuar në mënyrën më të përshtatshme dhe të favorshme, ku ai më vonë të bie dakord dhe të pranojë çdo urdhër të Krijuesit të tij. Zoti me këto vlera, i ka krijuar njeriut një themel shumë të fortë, ku më vonë gjatë jetës ai të bëjë dallimin e shumë gjërave dhe të jetë sa më i përshtatshëm sociologjikisht.

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se Pejgamberi Muhammed (a.s) ka thënë: "Çdo fëmijë lind në natyrshmërinë (në fenë e pastër të Allahut), pastaj prindërit e bëjnë atë hebre, të krishterë apo zjarrputist". - (Buhariu dhe Muslimi)

Mesazhi më i rëndësishëm i këtij hadithi është se çdo rob i Allahut lind i pastër dhe është i anuar nga e mira dhe e drejta në zgjedhje.

Që të kemi një individ sa më të formuar dhe të vlefshëm për ambientin e jashtëm, plot vlera sociologjike dhe psikologjike, arsimimi fetar ose edukata fetare luan një rol shumë të rëndësishëm.

Të gjithë ne në familjet tona kemi një fëmije, motër ose vëlla, kushëri në moshën e parë (fëminore). Si duhet të sillemi, ose cilat janë metodat që duhet të ndjekim që të kemi një edukim fetar sa më të shëndoshë? Gjithçka fillon nga e bukura dhe gjithmonë e bukura jeton gjatë në memorien e fëmijëve, atëherë hapi i parë është që fenë tua shpjegojmë në mënyrën më të bukur dhe argëtuese, tua bëjmë që ta duan fenë, nëse ndodh e kundërta, feja vjen në formën imponuese, monotone, pa emocion ose me dhunë, atëherë edhe disa vite më pas, fjala "fe" në memorien e këtij personi do ngjall pakënaqësi, mendime jo të këndshme dhe urrejtje.

Çdo institucion ose çdo familje që merr në dorë edukimin fetar të këtij personi, duhet të ketë parasysh që po luan një rol shumë të rëndësishëm në formimin e tij shpirtëror, arsimor dhe sociologjik. Do të thotë po e formon në aspektin e emocioneve dhe mendimeve, formimin fetar, zhvillimin natyror dhe se si do të sillet me njerëzit që e rrethojnë, me objektet që e rrethojnë dhe me ligjin.

Edukata fetare në Islam është detyrim për çdo familje dhe kjo është një përgjegjësi shumë e madhe. Familja është përgjegjëse për rritjen dhe formimin, mbrojtjen, arsimimin dhe edukimin e fëmijës, në këtë edukim dhe arsimim bën pjesë edhe ai fetar.

Hapi i parë në metodat e edukimit fetar të një fëmije është dashuria ndaj Krijuesit të tij, ndaj Pejgamberit të Allahut dhe përshtatja ndaj adhurimeve të Islamit. Ruajta ndaj çdo vesi të keq, mendimeve dhe sjelljeve të këqija. Allahu (xh.sh) në Kuranin famëlartë na urdhëron në këtë mënyrë: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënde djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët". (Kur'ani, Et-Tahrim: 6) Dhe në një hadith pejgamberi Muhammed (s.a.v) thotë: "Babai është përgjegjës për vendosjen e emrit sa më të bukur për fëmijën, për rritjen dhe edukimin e tij".

Andaj familja dhe rrethi i këtij individi duhen të kenë parasysh të gjitha metodat dhe kushtet e favorshme që të sjellin në funksion një individ me personalitet dhe me një karakter të shëndoshë.

SI NDRYSHON EDUKIMI FETARE SIPAS MOSHAVE TË FËMIJËVE?

Në edukimin fetar çdo moshë e fëmijëve bartë rëndësinë e vet. Për një edukim sa më të shëndoshë dhe të mirë është e rëndësishme që çdo nënë dhe baba të kenë një qëllim, një ide dhe një nijet të mirë për edukimin e tij. Periudha parashkollore më shumë fokusohet në pjesën e ndjeshmërisë së fesë, në të bukurën, në dashurinë e fesë, dhe në vlerat morale të fesë. Kjo zgjat deri në moshën 7-vjeçare, aty ku fillon edhe arsimimi shkollor, e këtu paralelisht me shkollën është edhe periudha e adhurimeve, ose e asaj që ne e quajmë "praktikimi i fesë".

Mosha 2-vjeçare është mosha mesatare ku fëmija fillon dhe të thotë fjalët e para dhe në këtë moshë fëmija është i interesuar që të gjejë kuptimin e çdo gjëje. Këtu fillon edhe roli më i rëndësishëm i familjes, çfarë flitet në familje, si sillen pjesëtaret e familjes. Fjalët dhe veprimet e më të mëdhenjve janë ato që mbesin më shpejt në memorien e fëmijës dhe ai në formën imituese i paraqet para nesh. Prandaj në këtë moshë është e pëlqyeshme që fëmijës t'i tregohen histori fetare, mësimi i fjalëve të bukura, si p.sh: shehadeti, selami, besmeleja, dëgjimi i Kur'anit etj. "Fëmijëve, fjala e parë që u duhet mësuar është LA ILAHE IL'LALLAH" - (Ibnul-Kajjum, Tuhvet'ut-Mevdud f.158).

Me vazhdimin e kohës, fillohet edhe mësimi i shtyllave të Islamit, besimit, por vlen të theksohet që gjatë këtij cikli është i rëndësishëm edhe zhvillimi i fëmijës, formimi i tij fizik dhe psikologjik, sepse jo çdo person është i prirur t'i ngjajë njëri-tjetrit, andaj është e rëndësishme që të jetë në mbikëqyrje personaliteti i tij.

Në këtë moshë fëmija ka nevojë për përkrahje ndaj tij, ka nevojë ta ndjejë veten të rëndësishëm dhe të dobishëm për të tjerët, e herë-herë edhe të shpërblehet. Andaj shpërblimi, ose vlerësimi me dhurata që bartin vlera fetare është shumë i rëndësishëm, si për shembull: takije, sexhade, libra me ngjyrosje, libra me foto objektesh fetare, këta dhe shume të tjerë e ndihmojnë më shumë fëmijën që të jetë sa më afër fesë.

Mësimi i duave (lutjeve) të shkurtra e bën atë që të lidhet sa më afër me Krijuesin e vet, ta falënderojë dhe t'i përulet Atij.

PERIUDHA E FUNDIT E FËMIJËRISË, 7-12 VJEÇ

Në këtë periudhë mund të themi se jemi në pikën më serioze dhe kritike të edukimit fetare. Pejgamberi Muhammed (s.a.v) na porosit ne në këtë mënyrë: "Kur fëmija të këtë mbushur moshën 7 vjeçare, mësojuani atyre namazin" (Ebu Davudi) . Hz Muhammedi (a.s) na urdhëron që në këtë moshë fëmija ka ardhur në kategorinë ku duhet të dijë dhe praktikojë adhurimet e obliguara. Ngaqë këto adhurime, siç është namazi, në fillim duhet mësuar rëndësia e tyre, vlerat, pastaj mënyra se si kryhen, leximi i sureve, leximi i duave, sexhdeja, rukuja dhe këto pas një periudhë kohe jo shumë të gjatë do kthehen në një mënyrë e të jetuarit të tij dhe pjesë e jetës.

Por nuk duhej harruar që fëmija në periudhën e fundit të fëmijërisë së tijë, përsëri fëmijë mbetet. Ndjenjat e tyre fëminore janë pasqyrim i veprimeve dhe sjelljeve të tyre prej fëmije. Andaj qoftë në mësimin e praktikimit të këtyre adhurimeve, duhet të dimë dhe të kemi kujdes që para nesh është një fëmijë, dhe islami në këto tema delikate na mëson të jemi të dashur, të butë, të duruar, të paqtë kur mësojmë këtë fe të bukur. Fëmijëve duhet fituar zemra, duhet përkrahur dhe vlerësuar puna e tyre, që kjo të jetë një mbështetje e krenarisë për ta. Prindërit kanë përgjegjësinë më të madhe ta bëjnë fëmijën që ta duan namazin, në formën me preçize dhe të saktë, nëse gjatë këtij rrugëtimi do ndodhë e kundërta atëherë do kthehet në një veprim të urryer. Fitimi i këtyre vlerave fetare ecën paralelisht me ato çka ofron rrethi dhe ambienti i jashtëm, një jetë sa më e shëndetshme fetare, do të thotë edhe një ambient i shëndetshëm fetar.

FAMILJA ËSHTË SHEMBULLI MË I MIRË NË TEMAT FETARE

Në zhvillimin e çdo fëmije kemi të bëjmë me dy cikle: "atë që e sheh- atë e vepron". Fëmija çfarë do të dëgjojë, atë do të thotë, çfarë do të shohë, atë do të veprojë. Familja është ajo ku gjatë çdo dite ia ofron fëmijës së tij një grumbull fjalësh dhe veprash, dhe ai e merr dhe e përpunon dhe e shfaq atë në mënyrën fëminore, por në të vërtet kjo nuk është tjetër veçse një imitim i asaj që atij i është ofruar. Fëmija në këtë moshë është në gjendje të "regjistrojë" dhe "memorizojë" çdo aktivitet të ditës së tij.

Për një fëmijë, familja është vendi ku mësohen principet e jetës. Të gjitha cilësitë e karakterit të tij fitohen në këtë ambient, qofshin këto pozitive apo negative. Çdo lëvizje dhe sjellje e pjesëtarëve të familjes janë shembull për të. Çdo familje do që fëmija i tyre të jetë një pasqyrim vlerash dhe të jetë shembull për këdo, por më e rëndësishme në këtë çështje janë vetë ata, nëna dhe babai, do të thotë a janë ata vetë shembull për të, ose a janë ata një pasqyrim vlerash?! Prindërit janë të detyruar që në fillim të plotësojnë veten e tyre pastaj fëmijën.

Fëmija më shumë është i prirë të mësojë nga shembujt dhe veprimet, nga sjelljet dhe lëvizjet, sesa nga fjalët ose nga ato që i urdhërojmë, andaj është e rëndësishme që të jemi shembull, jo veç nga ajo që themi, por edhe nga ajo që veprojmë. Fëmija vepron më shumë atë që sheh se sa atë që e dëgjon. Modeli për fëmijët është nëna dhe babai, prandaj çdo lëvizje dhe fjalë e tyre mbart një rëndësi të madhe. Në lidhje me këtë metodë kemi shembuj nga Kur'ani Famëlartë, ku Allahu thotë: "O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urryer ta thoni atë që nuk e punoni". (Kur'ani, Es-Saf: 2-3)

Një tjetër ajet: "A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni?" (Kur'ani, El-Bekare: 44)

Fëmijët kanë një cilësi memorizimi shumë të fuqishme, andaj ata ndjekin me kujdes çdo lëvizje, si për shembull: kur të mëdhenjtë çdo punë e fillojnë me "Bismillah", namazin e falin në mënyrën më të qetë dhe të paqtë, shkuarjen në xhami, agjërimin e Ramazanit, faljen e Bajramit, vizitat që e përcjellin Bajramin, përshëndetja e njëri-tjetrit me selam etj. Ai i jeton këto momente të bukura plotë ndjenja dhe kureshtje dhe është edhe ai i gatshëm që të jetë pjesë i këtyre veprimeve. Këto gjëra krijojnë një vend të rëndësishëm në memorien e tij dhe është e vështirë t'i harrojë dhe kështu me kohën, këto bëhen pjesë e jetës së tij. Do të jetë i gatshëm të dijë pse po i vepron këto, qëllimin e tyre, e këto me një edukim të mirë do ta formojnë atë dhe do ta bëjnë një musliman ideal për shoqërinë. Por, edhe njëherë kthehemi nga ajo që thamë më lartë, rëndësinë më të madhe në këtë mes e ka familja dhe kryesisht nëna dhe babai.

Nëse ne duam që islami të jetë një model për të gjithë ne, atëherë duhet që edhe ne të jemi model, kur ne të jemi model, atëherë edhe ata që na rrethojnë do të jenë model.

"EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)" - DR. MUHAMMED A. JEMANI

*(LIBËR I PËRKTHYER NGA **H. VEHBI S. GAVOÇI** - SHKODËR 1996)*

BONJAKU I BEKUAR

Filloi bekimi i Muhammedit (a.s) të ruajë kombin e vet e mbarë njerëzimin duke qenë ai ende pa lindur, në barkun e nënës së vet.

Atëherë, Ebrehe, oficer persian, desh të rrënonte Qaben e madhërueshme. Askush nuk mundi dot ta përballojë ushtritë e tij të formuara nga elefantët, ai desh të poshtërojë Meken e banorët e saj, desh të rrënonte ndërtesat fetare e të gjithë besimtarët.

Abdulmuttalibi hyri tek komandanti i ushtrisë dhe iu ankua se ushtarët e tij i kishin marrë 200 deve. Oficeri i tha: "Kujtova se erdhe të kërkosh që të ruhet Qabja, të mos rrënohet e jo për devet tuaja! Abdul Muttalibi iu përgjigj: "Devet janë të mijat, ndërsa Qabja ka Zotin e vet që e ruan!" Ofceri me krenari tha: "Jo, nuk do të mund të mbrohet e të ruhet nga ne!" Abdul Muttalibi pa u tundur nga e tija i tha që të bënte çfarë të donte.

Me këtë rast Zoti (xh.sh) dërgoi zogj të mëdhenj tufa-tufa, e secili prej tyre kishte nga një gur në sqep. Zogjtë i lëshuan gurët mbi kokat e ushtarëve duke i dënuar ata për krimin që ishin përgatitur të bënin. Komandanti shpëtoi në fillim, por pastaj edhe ai vdiq në rrugë duke u kthyer në vendin e vet i vetëm, pa roje e ushtarë.

Lidhur me këtë ngjarje, Zoti (xh.sh) i zbriti Muhammedit, pasi u zgjodh Profet, një sure të Kur'anit, suren El-Fil (Elefanti), e cila thotë: "A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit? A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar? Dhe ai kundër tyre lëshoi shpend që vinin tufa-tufa! Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (përtypur)."

Kjo ndihmë e madhe prej Zotit (xh.sh) qe një parapërgatitje për ardhjen e Muhammedit në këtë botë. Kjo ia shton nderin Qabes së madhërueshme, ia lartëson vlerën, rrit lidhjet e njerëzve me të, forcon dashurinë arabe për të e për banorët e saj.

Bekimet pasuan një pas një. Me lindjen e tij, xhaxhai Ebu Lehebi liroi robëreshën, kur ajo e përgëzoi për lindjen e Muhammedit. Ky gjest bamirësie u quajt si shenjë që, me rritjen

> **Bekimi më i madh erdh atëherë, kur Zoti e zgjodhi Muhammedin Profet për mbarë njerëzimin. Kështu u plotësua mëshira për të gjithë njerëzit që të dilnin nga errësira e zezë në dritën e drejtësisë, të vërtetës dhe të paqes.**

e këtij djali, njerëzimi do të përfitojë liri e drejtësi nga vëllai i vet dhe të gjithë njerëzit mbarë.

Është i njohur bekimi i Muhammedit (a.s) ndaj Halime Saedijes, e cila së bashku me të shoqin erdhi nga katundi Shifa për të gjetur fëmijë, që t'i rriste me qumështin e vet. Kërkoi e kërkoi, por nuk gjeti ndonjë fëmijë të pasur që familja dëshironte ta dërgonte në katund, siç ishte zakoni në ato kohëra, ku të rritej në ajër të pastër, në kushte të vështira jetese që të mësonte të përballonte vështirësitë. Qe të mos kthehej pa gjë, pranoi të rriste jetimin pa babë e të varfër, e si rrjedhojë gjeti lumturinë e dy jetëve.

Vetë Halimja tregon: "Erdhëm në Meke me një gomar të dobët e me një deve plakë e cila nxirrte shumë pak qumësht. Natën nuk fjetëm, se nuk na la fëmija që qante prej urie. Mirëpo, kur morëm Muhammedin (a.s) dhe e vura atë në prehër të pinte, gjoksi lëshoi qumësht më shumë.

Piu ai, sa deshi dhe djali im, sa u ngop. Atëherë fjetën gjithë natën pa u ndjerë.

Më vonë u zgjua burri të milte deven dhe ajo qiti qumësht shumë. Pimë edhe ne, deri sa u ngopëm e fjetëm si s'ka më mirë.

Të nesërmen u nisëm për rrugë, që të kthehemi në vendin tonë. Hipa unë me fëmijën në gomarin e dobët. Betohem se ai gomar që një ditë më parë mezi hidhte hapat, shpejtonte sa i kaloi gomarët e tjerë të rinj, saqë më thanë disa shoqe: "Halime, më ngadalë, a nuk është ky gomari i djeshëm?" Ju thashë që ai ishte. Ne nuk e dinim se kishte në shpinë të dashurin e Zotit, Muhammedin (a.s).

Arritëm në fisin tonë, me shtëpi bosh e me fëmijë të dobët. Betohem, nuk di të ketë tokë më djerr se tokat tona. Mirëpo shpejt ajo u gjelbërua nga bari i njomë e delet tona kullotnin sa ngopeshin. Kur i milnim, qitnin shumë qumësht e ngopeshim, ndërsa të tjerët nuk kishin një pikë qumësht, mbasi toka e tyre ishte djerr. Njerëzit u thonin barinjve të tyre: "Shkoni të kullotni delet atje ku janë delet e Halimes."

Një ditë më tha Humri: "O grua, ti ke sjellë një njeri të bekuar tek ne."

Qenia e Profetit (a.s) qe mëshirë për të gjithë. I mbrojti njerëzit që të mos e derdhnin gjakun kot në grindje a hakmarrje. Në ato kohëra vuri rregulla shumë të drejta që nderoheshin prej të gjithëve, sepse mbronin të drejtën e nderin e çdo fisi. Më vonë, kur zgjidhi mosmarrëveshjen e vendosjes së Gurit të Zi, mbrojti dinjitetin e nderen e të gjithë fiseve bashkë. Në atë kohë Profeti (a.s) ishte 38 vjeç.

Bekimi më i madh erdh atëherë, kur Zoti e zgjodhi Muhammedin Profet për mbarë njerëzimin. Kështu u plotësua mëshira për të gjithë njerëzit që të dilnin nga errësira e zezë në dritën e drejtësisë, të vërtetës dhe të paqes.

Dijetari Muhammed Ebu Zehre shkruan: "Mëshira buron nga dhembshuria e Zotit, mëshira nuk del veç prej atyre që kanë pësuar hidhërimin e dobësisë. A ka dobësi më të madhe se të jesh jetim?"

S'ka dyshim se lidhja e Muhammedit me një etiopiane (Bereqeten) ka pasur një mister të madh. Është e dobishme që njerëzit të dinë se ata janë të barabartë dhe se mirësia vjen nga puna e mirë dhe jo nga mburrja me fisin.

Është një mister i lartë të jetë një grua si nënë, për të cilën njeriu ka nevojë përherë, është mister që ajo jetime etiopiane, sikur të ishte rritur nën kujdesin e një femre prej familje të lartë do t'u thonte: "Sjellja e tij, e Muhammedit (a.s), u var prej asaj gruaje që e rriti dhe u interesua për të." Pra, mbasi kujdestarja e tij qe një jetime etiopiane, s'mund të thuhet se

dikush e ka edukuar, por thuhet, siç është e vërteta, se vetë Zoti (xh.sh) e ka edukuar. Vetë Profeti (a.s) ka thënë: "Zoti më ka edukuar e më ka përmirësuar në edukatë."

Cilësitë dhe sjelljet e mira të Profetit (a.s) janë dhunti e Zotit (xh.sh) Në Kur'anin Famëlartë thuhet: "A nuk të gjeti ty jetim e Ai të bëri vend (të dha përkrahje)? Dhe të gjeti të pa udhëzuar, e Ai ti udhëzoi. Dhe të gjeti të varfër e Ai të begatoi." - (Kur'ani, Ed-Duha: 6-8)

Vetë Profeti (a.s) ka thënë: "Unë jam zotëria i fëmijëve të Ademit", zotëria i tyre në edukatë, në rritje, në sjellje e në anë të tjera, zotëria i tyre në udhëheqje, zotëria i tyre në gradë te Zotit (xh.sh), i Cili e ka krijuar, e ka përmirësuar edukatën time, që të jem shembull i lartë, e simbol i njerëzimit mbarë.

Zoti (xh.sh) pastë mëshirë e rahmet mbi të!

Nuk është për t'u çuditur që, kur bënë fjalë Hz. Ebu Dherr-rri me Hz. Bilallin, e vë në radhën e të varfërve, prandaj pa u rritur mirë, u detyrua të punonte. Në rini punoi si çobani ku kulloste bagëtitë e të tjerëve me një rrogë të vogël. Rrogën ia jepte axhës së vet, Ebu Talibit, tek i cili banonte, përveç çka dëshironte t'i jepte ndonjë nevojtari.

Doemos puna e tij për ruajtjen e deleve ka qenë me dëshirën e Zotit (xh.sh), sepse këtë punë e kanë bërë edhe Profetë të tjerë para tij. Kjo punë e mëson njeriun të sillet butë e me mëshirë me të dobëtin, mëson durimin e mirësjelljen, afron të largëtin, zbutë të egrin duke e kthyer në shoqëri.

Ibn Is'haku tregon se Profeti (a.s) ka thënë: "Nuk ka Profet që nuk ka ruajtur delet". Dijetari Suhejli në librin e vet ka thënë: "Zoti (xh.sh) ka dashur që ata të ruajnë dele, me qëllim që të jenë ruajtës njerëzish e të jenë ruajtës të kombeve të tyre nën kujdesin e tyre." - (Sireh En-Nebevije, f.147)

Kur u rrit ai Zotëri, u mor me tregti.

> **Vetë Profeti (a.s) ka thënë: "Unë jam zotëria i fëmijëve të Ademit", zotëria i tyre në edukatë, në rritje, në sjellje e në anë të tjera, zotëria i tyre në udhëheqje, zotëria i tyre në gradë te Zotit (xh.sh), i Cili e ka krijuar, e ka përmirësuar edukatën time, që të jem shembull i lartë, e simbol i njerëzimit mbarë.**

duke e thirrur këtë të fundit: "O djali i zezakes'". Profeti (a.s) hidhërohet dhe i thotë Ebu Dherr-rrit: "Ti ke shenja të injorancës (të para islamit) kur njerëzit mburreshin me raca, me ngjyra e me fise."

Kur i dëgjoi Ebu Dherr-rri këto fjalë, e kuptoi gabimin, i kërkoi ndjesë shokut të vet, Bilalit, madje i përulet duke i thënë t'ia vërë këmbën mbi fytyrë. Por Bilali nuk pranoi dhe e fali."[1]

Profetin e bardhë e rriti një grua e racës së zezë, ai ka qenë djali i së bardhës dhe i së zezës bashkë. Dihet që Profeti tha më vonë për Bereqen, gruan e zezë: "Kjo është nëna ime". E nderonte përherë dhe gjithnjë i shprehte dashuri e përgëzime nga zemra.

I VARFËRI PASANIK

Abdullahu, babai i Profetit (a.s), vdiq duke i lënë djalit të vet trashëgim një skllave, Bereqeten, pesë deve dhe disa dele. Ky qe trashëgimi nga babai, gjë që

1. Sireh En-Nebevije, 130-131.

Në fillim shkoi në Siri me axhën e vet, Ebu Talibin.

U rrit ai Zotëri i mbrojtur nga imoraliteti i jetës së njerëzve në atë kohë, sepse Zoti (xh.sh) e kishte përgatitur për Profet e për një mision të shenjtë.

Filloi të dalë për tregti me pasurinë e Zonjës Hatixhe, grua e ndershme dhe e pasur. Ai fitoi shumë më tepër se të tjerët që tregtonin me mallin e Znj.Hatixhe. Kjo dhe shumë veprime të denja, fisnikëria e tij, sjellja shembullore, bënë që ajo Zonjë e madhe të kërkojë të martohet me Muhammedin (a.s). Ai Zotëri e ndihmoi të shoqen duke ia ruajtur e shumuar pasurinë. E ajo Zonjë iu gjend afër bashkëshortit duke e nderuar me sinqeritet. Iu fali Zoti (xh.sh) disa fëmijë të mirë e kështu asaj iu shtua dashuria ndaj atij Zotërie të madh.

Ebu Hajani përmes Xhefer Sadikut, duke komentuar Kur'anin Famëlartë thotë: "Muhammedi ka qenë jetim, që të mos thotë kush se unë i kam bërë nder duke e rritur ose duke e edukuar, që të sillet mirë." - (Subulul-Huda, f.392)

Ibni Amari në librin "Shfaqje e sekreteve" ka thënë: "Zoti (xh.sh) e rriti Muhammedin (a.s) jetim; si fillimi i çdo të rrituri është fëmijëria e fillimi i madhërisë është vobekësia e dobësia, me qëllim që Profeti (a.s), kur të rritej dhe të arrinte në kulm të madhërisë, të shihte që Zoti (xh.sh) e ka bërë të tillë dhe fuqia e njeriut nuk vjen nga babai apo nëna e tij, as nga pasuria, por vjen vetëm prej Zotit (xh.sh)".

Profeti (a.s) ka qenë jetim, begati e mëshirë. Vobektësia e tij ka qenë mirësi. Zoti vetë e ka edukuar, e ka nderuar dhe ka plotësuar formimin e tij.

O Zot i madh, salavati Yt le të jetë mbi atë Profet të nderuar, i cili ka qenë jetim, begati e mëshirë dhe vobektësia e tij ka qenë mirësi!

Zoti (xh.sh) në Kur'anin Famëlartë thotë: "Juve ju erdhi i dërguari nga llloji i juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët."[2]

Kur Zoti (xh.sh) bie salavat mbi të dërguarin, Profetin Muhammed (a.s), e gjithë njerëzia e ka për detyrë të bëjë një gjë të tillë, të bijë salavate mbi Profetin (a.s), për mëshirën e dhuruar, e cila iu bie të mirat e u ndalon të këqijat, heq vështirësitë dhe kërkesat e rënda që ishin në disa besime të së kaluarës dhe i udhëheq njerëzit për në rrugë të drejtë. Lidhur me këtë Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë: "All-lla, me të vërtetë e mëshiron Profetin (a.s) dhe melekët e tij. Lutuni për Të, o besimtarë! Lutuni për Të, e bini salavat mbi Të!"[3] Zoti di kujt ia jep misionin e Vet dhe e ngarkon me mëshirën e Tij.

2. Tevbe: 128
3. Kur'ani, El-Ehzab: 56.

Durim Kasemi
Imam, xhamia Parrucë

TRASHËGIMIA E FEMRËS DHE ÇËSHTJA E BARAZISË (2)

Rastet kur femra merr pjesë të njëjtë sa mashkulli

1. Në rast se trashëgimtarë janë nëna, babai dhe një fëmijë mashkull dhe dy vajza apo më shumë. Në këtë rast femra, nëna në rastrin konkret, merr pjesë të njëjtë sa mashkulli, babai në këtë rast. Kështu që nëse një person vdes dhe ka trashëgimtarë: babanë, nënën dhe djalin; pasuria ndahet në këtë mënyrë: babai 1\6, nëna 1\6, kurse djali merr pjesën e mbetur. Ose, nëse vdes bashkëshortja dhe trashëgimtarët janë: bashkëshorti, babai, nëna dhe vajza. Trashëgimia në këtë rast ndahet kështu: bashkëshorti 1\4, babai 1\6 + pjesën e mbetur, nëna 1\6, dhe vajza 1\2. Këtu vërehet se nëna ka marrë të njëjtën pjesë sa babai, ndërsa vajza ka marrë më shumë se babai dhe bashkëshorti që janë meshkuj.

2. Trashëgimia e vëllezërve nga nëna me motrat nga nëna. Thotë Allahu në suren En-Nisa, ajeti 12: "Në qoftë se (i vdekuri) është mashkull ose femër, e trashëgohet nga ndonjë i largët (pse s'ka as prindër as fëmijë) po ka një vëlla ose një motër (nga nëna), atëherë secilit prej tyre u takon një e gjashta, e në qoftë se janë më shumë (se një vëlla ose se një motër) ata janë pjesëmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë)". Ajeti e tregon qartë se në këtë rast si meshkujt ashtu edhe femrat marrin pjesë të barabartë nga trashëgimia.

3. Femra merr të njëjtën pjesë sikur mashkulli nëse personi që vdes është femër dhe ka lënë trashëgimtarë: burrin, nënën, dy motra nga nëna, e një vëlla nga nëna dhe nga babai. Në këtë rast trashëgimia ndahet në këtë mënyrë: bashkshorti merr 1\2, nëna 1\6, ndërsa vëllai nga babai dhe nëna dhe dy motrat nga nëna marrin pjesë të njëjta nga 1\3.

Në një mendim tjetër të juristëve islamë, vëllai nga babai dhe nëna në këtë rast nuk marrin asnjë pjesë sepse sipas rregullave ai këtu është trashëgimtarë jo me pjesë të caktuar por merr atë çfarë mbetet dhe në këtë rast nuk mbetet asgjë pasi t'i marrin të tjerët pjesët e tyre.

4. Femra merr të njëjtën pjesë sikur mashkulli nëse trashëgimlënësi vdes dhe trashëgimtarë është vetëm një femër, apo vetëm një mashkull. Në këtë rast sikur femra ashtu edhe mashkulli marrin të gjithë pjesën e pasurisë: një pjesë të përcaktuar dhe pjesën tjetër si të mbetur.

Në këtë rast dikush mund të thotë se femra këtu ka marr të gjithë pasurinë dhe të njëjtë me mashkullin, sepse nuk ka pasur trashëgimtarë tjetër? Përgjigja e kësaj pyetje është se, sikur ndarja e pasurisë të ishte bazuar mbi përkatësinë gjinore në këtë rast femra nuk do të merrte më shumë se i takonte në përqindjen e përcaktuara, por kjo e hedhë poshtë këtë pretendim.

5. Disa raste të tjera ku femra merr pjesë të njëjtë sikur mashkulli

Kur trashëgimtarë janë bashkëshorti dhe vëllai nga nëna dhe babai, ose motra nga nëna dhe babai. Në këtë rast pasuria ndahet në dy pjesë dhe secili merr 1\2.

Kur trashëgimtarë janë : bashkëshorti, nëna, motra nga nëna dhe vëllai nga nëna e babai. Në këtë pasuria ndahet në gjashtë pjesë, ku bashkëshorti merr 1\2, që janë 3\6 e pasurisë, kurse pjesëtarët e tjerë marrin të gjithë nga 1\3 e pasurisë. Siç vërehet, motra nga nëna edhe pse është më e largët ka marr të njëjtën pjesë sikur vëllai nga nëna dhe babai.

Numri i personave që nuk mund të konsiderohen asnjëherë si të padenjë për të trashëguar është gjashtë, tre janë meshkuj dhe tre femra. Kjo është një shenjë treguese se nuk ka dallim në trashëgimi bazuar mbi gjininë në shenjë diskriminimi.

Rastet kur femra merr më shumë se mashkulli[1]

Përpara se të flasim në lidhje me rastet kur femra merr më shumë se mashkulli, po përmendim mënyrat e përfitimit të trashëgimisë sipas islamit. Përfitimit i trashëgimisë sipas Islamit bëhet nëpërmjet dy mënyrave:

1. Trashëgimia me pjesë të përcaktuar në Kur'an dhe Sunet. Kjo do të thotë që: trashëgimtari merr atë çfarë i ka përcaktuar Allahu si: 2\3, 1\3, 1\6, 1\2, 1\4, ose 1\8. Këto janë pjesët që janë përcaktuar.

2. Mënyra e dytë e përfitimit të trashëgimisë është nëpërmjet "Asabes" (njerëzit e afërt nga babai). Kjo do të thotë që trashëgimtari merr të gjithë pjesën e mbetur të trashëgimisë pasi të kenë marrë personat që marrin me pjesë të paracaktuar nga Kurani dhe Suneti. Personat që përfitojnë me këtë mënyrë janë: djali i djalit, sado që të zbresë në gradën e të paslindurve, babai apo gjyshi, sado që të jetë lart në gradën e të paralindurve, vëllezërit nga nëna dhe babai dhe ata nga babai dhe fëmijët e tyre etj.

Nga verifikimi i rasteve të trashëgimisë së femrës është vërejtur se femra merr më tepër kur trashëgon me pjesë të paracaktuar, sesa me "Ta'sib" (afërsinë e lidhjes nga babai).

Marrja e 2\3 nga një herë është më e dobishme për femrën, se sa të trashëgojë si arabe (afërsinë e lidhjes nga babai), bashkë me mashkullin dhe merr pjesë më shumë se mashkulli

Kështu që, nëse trashëgimlënësi vdes duke lënë një pasuri prej 60 milion lekësh dhe ka lënë si trashëgimtarë bashkëshortin, babanë, nënën dhe dy vajza. Pasuria ndahet në këtë mënyrë: bashkëshorti 1\4, që i bie 12 mln, babai 1\6 + pjesën tjetër "ta'sib" (afërsinë e lidhjes nga babai) që i bie 8 mln, nëna 1\6 që i bie 8 mln, dhe dy vajzat 2\3 e pasurisë që i bien 32 mln. Ndërsa nëse në të njëjtin rast në vend të dy vajzave do ishin dy djem, ata do të merrnin 25 mln, pra më pak se vajzat. Shikohet qartë se vajzat në këtë rast kanë marr më shumë se çdo trashëgimtarë tjetër.

Në rast se trashëgimlënësi do linte 48 milion dhe trashëgimtarë do të ishin: bashkëshorti, dy motra nga nëna dhe babai dhe nëna, pasuria do të ndahej kështu: bashkëshorti 1\2, që i bie 18 mln,dy motrat nga babai 2\3, që i bie 24 mln, dhe nëna 1\6, që i bie 6 mln. Nëse në ven të dy motrave të ishin dy vëllezër ata do të merrnin 16 mln. Vërehet qartë dallimi mes sasisë që merr femra në këtë rast dhe asaj që merr mashkulli.

1\3 nganjëherë mund të jetë më e mirë për femrën, se sa të trashëgojë me "ta'sib" (afërsinë e lidhjes nga babai) bashkë me mashkullin, siç edhe është në rastin në vijim nëse trashëgimlënësi vdes dhe lë 48 milion dhe trashëguesit janë: bashkëshortja, nëna, dy motra nga nëna dhe dy vëllezër nga nëna e babai. Pasuria ndahet në këtë mënyrë: bashkëshortja 1\4, që i bie 12 mln, nëna 1\6, që i bie 8 mln, dy motrat 1\3, që i bie 16 mln, dhe dy vëllezërit pjesën e mbetur, që i bie 12 mln. Siç shikohet motrat kanë marrë më shumë se vëllezërit.

1\6 nganjëherë mund të jetë më e mirë për femrën, se sa trashëgimi me "ta'sib" (afërsinë e lidhjes nga babai) bashkë me mashkullin. Nëse trashëgimlënësi vdes dhe trashëgimia që ka lënë është 60 milion, dhe trashëgimtarët janë: bashkëshorti, nëna, motër nga nëna dhe dy vëllezër nga nëna e babai. Në këtë rast pasuria ndahet si më poshtë . Bashkëshorti merr 1\2, që i bie 30 mln, nëna 1\6, që i bie 10 mln, motra 1\6, që i bie 10 mln, gjithashtu edhe vëllezërit marrin pjesën e mbetur, që i bie 10 mln. Edhe këtu shikohet qartë se motrat kanë marrë më shumë se vëllezërit.

Rastet kur femra merr pjesë nga trashëgimia dhe mashkulli i njëjtë me të nuk merr

Ka disa raste kur femra përfiton nga trashëgimia, ndërsa mashkulli nuk merr asgjë. Disa prej këtyre rasteve janë:

Nëse personi vdes dhe ka lënë trashëgimi 195 mln, dhe trashëgimtarët që përfitojnë janë : bashkëshorti, babai, nënë, vajza, dhe vajza e vajzës. Trashëgimia në këtë rast ndahet kështu: Bashkëshorti merr 1\4, që i bie 39 mln. Babai merr 1\6 + pjesën tjetër "ta'sib" (afërsinë e lidhjes nga babai), që i bie e gjitha 26 mln. Vajza merr 1\2, që i bie 78 mln. Vajza e vajzës merr 1\6 që i bie të jetë 26 mln. Nëse në vend të vajzës së vajzës të ishte djali i vajzës, në këtë rast nuk merrte asgjë.

Nëse personi vdes dhe lë një pasuri prej 48 milion dhe trashëgimtarët janë: bashkëshorti, motra nga nëna e babai, dhe motra nga babai. Në këtë rast pasuria ndahet në shtatë pjesë dhe, bashkëshorti merr 3 pjesë, motra nga nëna dhe babai merr 3 pjesë, ndërsa motra nga babai merr 1 pjesë. Sikur në vend të motrës nga babai të ishte vëllai nga babai ai nuk merrte asgjë .

Në shumë raste, gjyshja nga babai merr dhe gjyshi po nga babai nuk merr. (ndërsa gjyshërit nga nëna nuk marrin nga trashëgimia).

1.1 Në këtë pikë janë në të vërtetë dhjetë raste por , kam përmendur vetëm katër, sepse rastet e tjera janë me të njëjtën përqindje dhe pjesë. Gjithashtu edhe për të mos e zgjatur më tepër shkrimin .

KUR VENDI YT NUK TË VLERËSON DHE VENDI HUAJ TË NDERON!

Presidenti i Italisë, z. Sergio Mattarella, me ftesë nominale nga ana e tij, ka ftuar studiuesen shkodrane Dr. as. Egesta Lopçi, në takimin e vitit që zhvillon presidenti me studiuesit dhe shkencëtarët e Italisë, ku ajo ishte e ftuar si personalitet në fushën e mjekësisë me zbulimet dhe kërkimet e saj shkencore.

Dr. as. Egesta Lopçi, me titull "Mirënjoha e qytetit të Shkodrës", që i është dhënë me kërkesë të Myftinisë Shkodër në vitin 2015, falë kontributit të saj në fushën e mjekësisë bërthamore, me studime të ndryshme në këtë fushë, po nderohet në shumë vende të botës për punën e saj kërkimore.

Ajo është pjesëmarrëse dhe ligjëruese në shumë panele shkencore në fushën e mjekësisë bërthamore të qendrave kërkimore shkencore botërore.

Edhe pse mbartë në kokë shaminë e femrës myslimane, atë nuk e ka penguar kjo gjë të ndjekë rrugën e kërkimit të diturisë dhe shkencës, madje në një shtet perëndimor dhe me rezultatet të shkëlqyeshme, saqë menjëherë pas përfundimit të universitetit të Bolonjës, Itali është punësuar në Humanitas Cancer Center, Milano.

Rezultatet dhe arritjet e kësaj vajze myslimane të përkushtuar dhe me shaminë islame, tregojnë më së miri se, femra islame është e aftë të japë kontributin e saj në shkencë dhe në çdo fushë të jetës dhe se shamia nuk është përbën aspak pengesë, ndoshta vetëm në vende si Shqipëria, ku femrës myslimane në shumë raste i privohen të drejtat e saj, si ajo e punësimit në administratën publike, por shpeshherë edhe në atë private.

Në vitin 2006 - Diplomohet në Mjekësi, Universiteti i Bolonjës, ALMA MATER STUDIORUM, Itali.

Në vitin 2011, kryen Specializimin për Mjekësi Bërthamore, Universiteti i Bolonjës, ALMA MATER STUDIORUM, Itali.

Në vitin 2013 - merr PhD në Specializim për Shkencat Mjekësore (cikli XXVII) Universiteti i Bolonjës, ALMA MATER STUDIORUM, Itali.

Ndërkohë që ka me dhjetëra studime të bëra në fushën e mjekësisë bërthamore dhe njëkohësisht është bashkautore e disa librave në fushën e mjekësisë.

MYFTIU MBAJTI HYTBEN E PARË NË XHAMINË RE TË SHTUFIT

Ditën e xhuma, më 20 tetor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti hytben e tij të parë në xhaminë e re të fshatit Shtuf, Ana e Malit.

Para të pranishëmve, Myftiu bëri thirrje që mësimet dhe udhëzimet e fesë islame të përhapen me shumë dashuri dhe mëshirë për krijesat e Zotit, duke u mbështetur tek shembulli i Hz. Muhammedit (a.s) dhe ai i sahabëve të tij, të cilët sakrifikuan çdo të shtrenjtë për përhapjen e fesë dhe dritës së saj për njerëzimin.

Myftiu tha se përtej përhapjes së propagandave islamofobe, që kanë akses në media dhe politikë, ne si muslimanë e kemi për detyrë të shenjtë të bartim me dinjitet dhe krenari legjitime bardhësinë dhe bukurinë e Islamit, mësimeve të Kur'anit dhe traditat e Hz. Muhammedit (a.s).

"Ne nuk mallkojmë njeri, përkundrazi lutemi siç na ka mësuar i dërguari i All-llahut, që Zoti i gjithësisë të udhëzojë drejt dritës së Tij mbarë njerëzinë! Sepse ne i duam të mirën dhe udhëzimin çdokujt prej racës sonë, njësoj si ia duam vetes sonë! Prandaj, mos u lëkundni në fenë tuaj, mos u mashtroni pas thirrjeve shterpë të armiqve të fesë dhe vetë njerëzimit, që punojnë ditë-natë kundër kësaj feje të pastër islame, e cila ka garancinë e All-llahut, se do të triumfojë mbi krejt thirrjet, kurdo e kudo!", tha ndër të tjera Myftiu.

Njëkohësisht, ai falënderoi përkushtimin e imamit të xhamisë dhe besimtarëve, që me besnikëri e pastërti zemrash, i japin jetë e gjallëri kësaj xhamie të ngrohtë në këtë zonë muslimane me tradita shekullore.

MYFTIU: "KY ISLAM ËSHTË FÉ E MËSHIRËS, JO E TERRORIT!"

Nga xhamia e fshatit Kullaj, mbrëmjen e së dielës, më 22 tetor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka ftuar besimtarët të kapen sa më shumë pas mësimeve dhe udhëzimeve të fesë islame, si ajka e shpalljeve hyjnore dhe vula e krejt dërgesave shekullore.

Në ligjëratën e tij, Myftiu tha se muslimani karakterizohet nga cilësitë më të larta që e bëjnë njeriun të jetojë me dinjitet e krenari, mëshirues e falës, ndërtues i jetës dhe garant i paqes dhe vlerave në të.

"Sa madhështor është ky Islam! Prezantimin e parë me njerëzinë, Zoti ynë e ka bërë në këtë mënyrë: "Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve. Mëshiruesit, Mëshirëbërësit". Të dërguarin e fundit e cilësoi me ajkën e cilësive: "Nuk të kemi dërguar, vetëm se Mëshirë për mbarë botët". Vetë i dërguari (a.s) na udhëzoi: "Mëshironi, të mëshiroheni..!"

Imagjinoni se sa padrejtësi na bëhet ne muslimanëve dhe fesë tonë, kur etiketohemi ne dhe feja e jonë me terrorizmin, ekstremizmin, dhunën, intolerancën?!

Prandaj, armiqtë e Islamit, që janë në vetvete edhe armiq të njerëzimit, nuk do të kenë kurrë sukses në propagandat e tyre mjerane kundër kësaj feje dhe pasuesve të saj, që kanë në thelb mëshirën!

Ky Islam është fé e mëshirës, jo e terrorit!", tha ndër të tjera Myftiu.

MYFTIU I SHKODRËS DEKOROHET NGA FRI SHKUP

Mbrëmjen e së hënës, më 23 tetor 2017, Forumi Rinor Islam për të shtatëmbëdhjetën herë me radhë organizoi manifestimin tradicional të Vitit të Ri islam Hixhri 1439 në Teatrin Kombëtar Maqedonas në Shkup.

Ky manifestim filloi me leximin e disa ajeteve kuranore nga hafiz Egzon Ibrahimi nga Kosova. Më pas të pranishmit duke iu uruar mirëseardhje i përshëndeti kryetari i Forumit Rinor Islam, zotëri Fisnik Shabani i cili mes tjerash tha: "Hixhreti është një kthesë e madhe në shoqëri, është një kthesë nga jeta pasive në atë aktive. Edhe koha që jetojmë në vendin tonë karakaterizohet me kohë të vështira, jostabilitet, probleme të shumta shoqërore, politike dhe ekonomike. Dhe kështu rinia që paraqet shpresën e popullit mbetet në shumë udhëkryqe. Mu nga kjo, Forumi Rinor Islam ka fokusuar elanin e vet që të punojë me këtë shtresë të shoqërisë me qëllim që ta mbrojë, ta edukojë dhe ta forcojë për t'u përballur me këto sfida."

Forumi Rinor Islam në vazhdimësi promovon një nga qëllimet kryesore: stimulimin e diturisë dhe shkencës, nxënien e dijes. Kjo dëshmohet më së miri përmes dekorimit të nxënësve dhe studentëve më të dalluar. Nga shumë shkolla të mesme të qyteteve të Republikës së Maqedonisë u dekoruan nxënësit më të mirë. Poashtu u dekoruan edhe studentët më të dalluar të fakulteteve të ndryshme nga universitetet: Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, Universiteti Shën Qirili dhe Metodi, Universiteti i Tetovës dhe Universiteti i Europës Jug-lindore.

Si hafizi më i ri u dekorua 14 vjeçari hafiz Burak Iseni. Ndërkaq pas konkursit të shpallur si shkencëtar i vitit çmimin e fitoi Dr. Arlind Farizi nga Tetova. U bë edhe dekorimi i disa personaliteteve dhe subjekteve për kontribut dhe arritje të veçant.

Post mortum u dekorua hoxhë Rexhep Voka, ndërkaq të dekoruarit tjerë ishin: mësuese Ajshe Dalipi, Myftiu i Shkodrës hoxhë Muhamed Sytari, OJQ "Horizonti" nga Mali i Zi, dhe K.F "Shkëndija" nga Tetova.

Në emër të dekoruarve të pranishmit i përshëndeti hoxhë Muhamed B. Sytari, i cili, ndër të tjera tha: "Falënderoj organizatorët dhe të gjithë pjesëmarrësit për këtë tubim të mrekullueshëm dhe për këtë vlerësim për secilin prej nesh që është një dëshmi e madhe e respektit të organizatorit për vlerat në krejt trojet tona shqiptare."

Si çdo vit edhe kësaj radhe ky manifestim ishte i pasur edhe me disa pika artistike. Recitalin "Rrugë të mbarë" të shkruar nga Fatmir Muja dhe poezinë "Din e dije" e shkruar nga hoxhë Rexhep Voka, para numrit të madh të pranishmëve, i interpretoi aktori Adrian Aziri.

Dhe mysafir i kësaj mbrëmjeje ishte kënduesi i mirënjohur i ilahive, Mesut Kurtish i cili këndoi dy ilahi nga albumi i tij i fundit. Në fund me dekoratë të veçantë u dekorua studenti nga Shkupi Emir Fetai i cili ka përfunduar studimet në Stamboll dhe është shpallur studenti më i mirë në mesin e 1200 studentëve të atjeshëm.

(Me përshtatje, nga: www.fri.org.mk)

TAKIM MBI PROBLEMATIKAT E PUNËS NË MYFTININË E SHKODRËS

Ditën e martë, më 24 tetor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me stafin e Myftinisë, ku u diskutua mbi disa problematika të punës së përditshme të Myftinisë Shkodër dhe shfrytëzimit të vakëfeve të shenjta.

Fillimisht, Myftiu kërkoi shpjegime për vonesën e shkaktuar për shfrytëzimin e vakëfeve në Zdralej, ku Myftinia Shkodër është pronare legjitime e disa vakëfeve.

Tregu i madh, pastrimi i të cilit po mbahet peng abuzivisht nga burokracitë e Bashkisë Shkodër, si dhe pjesa e vakëfit bri Qendrës Tregtare, që keqpërdoret nga zaptuesi Muharrem Goka. Disa herë Myftinia Shkodër ka tentuar të vërë në efiçencë vakëfin e saj në atë zonë, por është përballur me pengesa të pakuptueshme, që kanë çuar deri në konflikte të patolerueshme fizike.

Myftiu udhëzoi që pa humbur kohë, të shfrytëzohet pjesa e vakëfit pranë QT, si dhe të nisë marrja e qerave të krejt shitësve që shfrytëzojnë tregun e Zdrales, mbi vakëfin e Myftinisë Shkodër, derisa të kryhet shpërngulja e plotë e atij treg, që i lejon Myftinisë fillimin e punës për ndërtimin e Qendrës Tregtare bashkëkohore, që ka prej gati një viti të gjitha lejet zyrtare.

Në këtë takim u diskutua edhe mbi çështje që lidhen me rininë, botimet etj.

NJË DITË MBRESËLËNËSE NË KOMPLEKSIN E XHAMISË SË GOLEMIT, KAVAJË

Ditën e enjte, më 26 tetor 2017, një grup imamësh dhe këshilltarësh të Myftinisë Shkodër, vizituan Kompleksin bashkëkohor të xhamisë së re të Golemit në Kavajë, me rastin e aktivitetit me temë: "Islami dritë për zemrën", ku ligjëroi Imam Muhamed B. Sytari, Mufti i Zonës Shkodër.

Pas disa ndalesa të këndshme, namazeve dhe vizitës në kompleksin shumëfunksional të kësaj xhamie të pashoqe në Shqipëri, imamët u takuam edhe me imamë e thirrës islamë të Kavajës, si dhe me Myftiun e saj, H. Besnik Leçini.

Në aktivitetin e mirëorganizuar, ligjëruan dhe përshëndetën edhe të ftuar nderi nga Arabia Saudite, Myftiu i Kavajës dhe imami i kësaj xhamie, njëkohësisht organizatori kryesor i këtij tubimi me vlerë, z. Gëzim Shahu.

Ndërkohë, në ligjëratën e tij, Myftiu i Shkodrës, vuri theksin tek domosdoshmëria e rileximit të Kur'anit dhe traditave profetike, për të vendosur një marrëdhënie të ekuilibruar ndërmjet fesë dhe elementëve të tjerë në jetë.

Ndër të tjera theksoi: "Ne sot, jemi të ftuar ta jetojmë Islamin tonë, larg frikësimeve që i bëhen botës me emrin e tij, duke e keqpërdorur etiketën islame aty-këtu; herë nga jashtë e po aq nga brenda familjes islame!

Nuk janë të fshehta për krejt ju sot, etiketimet mjerane që i atribuohen fesë islame nga perëndimi, por jo vetëm.

Terma të tilla të papranueshme dhe krejtësisht të refuzueshme, si: "terrorizmi islam", "ekstremizmi islam" e të ngjashme, kanë mjegulluar jo pak arsyen e shëndoshë të botës sonë, mbarë njerëzimit, që gjithësesi, nuk mund të vijojë rrugëtimet e hutuara, mbi këtë sokak të pasigurtë dhe mashtrues, përballë të vërtetave të vetë fesë sonë islame!

Jo më pak të dëmshme nga këto sulme politike dhe mediatike, (që përveçse kanë abuzuar me të vërtetat e fesë sonë, kanë kthyer edhe një pjesë të mirë të gjeografisë së ymetit islam në gërmadha lufte e shkatërrimi në masë), janë izolimet sektare brenda familjes, ku çdo grup e sekt, e sheh veten si "grupi i shpëtuar", pos së cilit, të gjithë janë të njollosur në besim e fé! Ky është mjerim mbi mjerimin!

Kësisoj, sot, ne kemi nevojë të çlirohemi nga përkatësitë sektare dhe influencat e politikave të huaja, për t'u kthyer nga Islami ynë dhe ekuilibrat e tij, që na dhurojnë krenari e dinjitet, vlerat më të larta të harmonisë komunitare, elementët më të spikatur të vëllazërisë së sinqertë islame, në burim të së cilës qëndron ajeti i vëllazërisë!"

Aktiviteti u ndoq nga një numër i madh të ftuarish, kryesisht mosha e re, si dhe media vizive.

KËSHILLA VËLLAZËRORE ME IMAMËT E MALËSISË SË MADHE

Këshilla vëllazërore me imamët e Malësisë së Madhe

Paraditën e së dielës, më 29 tetor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në takimin e radhës së imamëve të Myftinisë së Malësisë së Madhe.

Në takimin vëllazëror, që u drejtua nga Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, u vu theksi te angazhimet e imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë në drejtim të rritjes dhe perfeksionimit të shërbimeve ndaj fesë dhe përhapjes së mesazhit islam tek krejt individët e shoqërisë.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës iu drejtua imamëve të pranishëm me një këshillë nga këshillat e dijetarit të shquar islam, H. Vehbi Gavoçi, drejtuar thirrësve islamë.

Myftiu theksoi se imamët e kanë për detyrë nderi dhe përzgjedhjeje nga Zoti i gjithësisë, të përhapin mesazhet origjinale të fesë islame, pa pasur

ndrojtje e pa e ulur zërin, si dhe duke shfaqur sinqeritet e dashuri për këtë mision të shtrenjtë.

Më pas, Myftiu zhvilloi një bashkëbisedim edhe me nxënësit frekuentues të kurseve fetare që organizon Myftinia e Malësisë së Madhe në xhaminë e Koplikut.

Me rastin e këtij takimi, për imamët pjesëmarrës u shpërndanë disa botime të Myftinisë Shkodër.

ZAPTIMI I VAKËFEVE, SHQETËSIM I PATOLERUESHËM

Zaptimi i tokave vakëf, legalizimi i ndërtimeve pa leje, si dhe tendenca për të grabitur dhe tjetërsuar vakëfet e shenjta në vendin tonë ngelet një shqetësim i patolerueshëm për Myftininë Shkodër.

Janë bërë përpjekje të shumta për kthimin në identitet të këtyre pasurive, por për fat të keq, akoma sot, në fund të vitit 2017, asnjë qeveri e zgjedhur edhe me votat e qytetarëve muslimanë, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur dhe seriozitetin që i takon kësaj çështjeje me prioritet mbarëkombëtar.

Dosje të shumta presin zgjidhje të menjëhershme, ndërkohë që drejtësia nuk e ka thënë si duhet dhe ndershmërisht fjalën e saj.

Sa e sa herë, institucione si: INUK e INUV, Bashkia Shkodër, Prokuroria e Policia, nuk kanë qenë në nivelin e duhur të bashkëpunimit për të çuar në vend vendime në favor të Myftinisë Shkodër.

Përtej kësaj, përpjekjet dhe beteja e Myftinisë Shkodër vazhdon pa ndërprerje deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.

Edhe ditën e enjte, më 2 nëntor 2017, Myftiu diskutoi me stafin e tij rreth disa prej vakëfeve që kërkojnë zgjidhje, për të evituar edhe konflikte fizike me individë të papërgjegjshëm, që kanë zaptuar këto toka.

Myftiu përsëriti se çështja e vakëfeve është shqetësim i patolerueshëm, që nuk duhet të ketë asnjë lëshim për këdo që shkel dinjitetin e tij dhe se Myftinia Shkodër nuk do të tërhiqet përballë kujtdo që përpiqet të grabisë e të prekë pronat e saj!

MYFTIU: "FUSHA E TABAKUT, VAKËF SHEKULLOR I MUSLIMANËVE TË SHKODRËS!"

Ditën e xhuma, më 3 nëntor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti hytben e xhumasë në xhaminë e Plumbit.

Nga minberi i kësaj xhamie, Myftiu nisi një cikël të ri hytbesh kushtuar përkushtimit dhe dashurisë së sahabëve për të Dërguarin e All-llahut, si pikënisje drejt kuptimit të drejtë të marrëdhënies së muslimanit me fenë e tij, familjen, shoqërinë.

Pas përfundimit të lutjeve të kësaj xhumaje, Myftiu, i shoqëruar edhe nga stafi i tij dhe besimtarët, zhvilloi një vizitë tek vakëfi i Fushës së Tabakut, ku gjenden edhe gjurmët e minares së xhamisë së vjetër të Tabakut.

Myftiu theksoi se vakëfet janë amanet i shenjtë, që trashëgohet brez pas brezi, duke trashëguar dinjitetin, besën,

krenarinë, bujarinë dhe cilësitë më të mira të muslimanit!

Ai lajmëroi njëkohësisht edhe caktimin e z. Abdullah Myftija si përgjegjës dhe kujdestar të këtij vakëfi.

Njëkohësisht dha udhëzim që Fusha e Tabakut të pastrohet deri të xhumanë e ardhshme, kur Myftinia Shkodër do të organizojë edhe faljen e xhumasë në sheshin e këtij vakëfi.

NIS PUNA PËR PASTRIMIN E VAKËFIT TE FUSHA E TABAKUT

Paraditën e së dielës, më 5 nëntor 2017, Myftinia Shkodër nisi punën për pastrimin dhe rrethimin e vakëfit te Fusha e Tabakut, bri xhamisë së Tabakut.

Më herët, ditën e xhuma, pas faljes së xhumasë në xhaminë e Plumbit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dha udhëzimet e tij për sistemimin e kësaj prone shekullore, në hapësirat e së cilës ndodhen edhe pjesë të mbetura nga xhamia e vjetër e Tabakut dhe çinari shekullor.

Ditën e sotme, po punohet në grup që të sistemohet ky vakëf dhe të bëhet gati për faljen e xhumasë së ardhshme.

Pas inspektimit të punimeve, Myftiu falënderoi grupin e punës nën drejtimin e menaxherit të pronave, z. Blendi Alushi dhe konfirmoi se Myftinia Shkodër nuk do të tolerojë tjetërsimin e këtij vakëfi dhe të krejt trashëgimisë së saj shekullore.

"MIRËNJOHJE" PËR MYFTIUN E KOSOVËS, MR. NAIM TËRNAVA

Ditën e xhuma, më 10 nëntor 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, Myftiun e Republikës së Kosovës, Mr. Naim Tërnava, me ekipin e bashkëpunëtorëve të tij.

Në këtë vizitë vëllazërore, Myftiun e nderuar e shoqëronte edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Skënder Bruçaj.

Gjatë këtij takimi të përzemërt, Myftiu i Shkodrës e falënderoi Myftiun Tërnava për këtë vizitë të shënuar, sidomos kur ajo vjen në këtë periudhë të vitit që ka një rëndësi të posaçme për muslimanët e Shkodrës, që përkon me përkujtimin e përvjetorit të rihapjes së Xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës i dorëzoi Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim Tërnava, një "Certifikatë Mirënjohjeje", për kontributin e tij të shquar në shërbim të vlerave më të spikatura islame dhe kombëtare, si dhe për qëndrimet e tij dinjitare në mbrojte të trashëgimisë islame dhe kombëtare.

Myftiu tha se kontributet e Bashkësisë Islame të Kosovës për Shkodrën janë të pamohueshme gjatë këtyre viteve të rimëkëmbjes islame, qysh pas rilejimit të aktivitetit fetar me ligj në vendin tonë.

MYFTIU I KOSOVËS, MR. NAIM TËRNAVA, MBAJTI HYTBEN E XHUMASË NË XHAMINË E PARRUCËS

Me ftesë të Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ditën e xhuma, më 10 nëntor 2017, hytbeja e javës në xhaminë e Parrucës u mbajt nga Myftiu i Republikës së Kosovës, Mr. Naim Tërnava.

Në kuadër të aktiviteteve në përkujtim të rilejimit me ligj të fesë në vendin tonë, pas 23 vitesh persekutimi dhe ndalimi të aktivitetit fetar në Shqipëri, kjo hytbe e shënuar kishte një vlerë të madhe për mesazhet e urta dhe largpamëse të Myftiut Tërnava.

VIZITË VËLLAZËRORE E MYFTIUT DHE IMAMËVE TË KAVAJËS

Ditën e shtunë, më 11 nëntor 2017, Myftiu i Kavajës, H. Besnik Lecini me imamët e Kavajës zhvilluan një vizitë vëllazërore në qytetin e Shkodrës.

Me këtë rast, ata u pritën nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari me bashkëpunëtorë.

Në kuadër të përkujtimit të ditës historike të 16 nëntorit 1990, së bashku, ata zhvilluan një vizitë në Xhaminë e Plumbit, që është kthyer tashmë në kiblen e rimëkëmbjes së historisë së Thirrjes Islame në Shqipëri.

Pas përshëndetjeve të dy myftive të nderuar, të pranishmit dëgjuan edhe disa të dhëna me vlerë nga kujdestari i Xhamisë së Plumbit, H. Mithat Myftija rreth historikut të kësaj xhamie dhe emocioneve të nëntorit 1990, kur pas shumë përgatitjeve, më 16 nëntor të atij viti, u zhvillua edhe ceremonia historike e faljes së xhumasë së parë masive pas errësirës ateo-komuniste.

Më pas, vizita vijoi në xhaminë e Medresesë, me ç'rast u zhvillua edhe një përshëndetje për xhematin dhe djemtë e konviktit të djemve.

Gjatë përshëndetjeve të dy myftive, u vu theksi te domosdoshmëria e bashkëpunimit, tejkalimit të sfidave të reja me të cilat përballet bashkësia e muslimanëve shqiptarë, distancimit nga tendencat përçarëse dhe gjendjes së pasivitetit në raport me realitetin.

AKTIVITET ARSIMOR DHE ARGËTUES MES NXËNËSVE TË XHAMIVE BARDHAJ DHE MES-MYSELIM

Të shtunën, më 11 nëntor 2017, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër organizoi në xhaminë Bardhaj një aktivitet me nxënësit e kësaj xhamie dhe nxënësit e kurseve fetare të xhamisë Mes-Myselim.

Drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, gjatë takimit me nxënësit u mbajti një bisedë fetare, ku foli për rëndësinë që ka zhvillimi i mësim-besimit, për njohuritë kryesore të Islamit dhe për edukimin e brezave sipas frymës tradicionale islame, besimit dhe moralit që duhen të karakterizohen me përkushtimin e vazhdueshëm ndaj Zotit (xh.sh), dashurinë dhe harmoninë më të gjithë njerëzit dhe krijesat e Tij.

Z. Halluni falënderoi mësuesit e dy xhamive Bardhaj dhe Mes-Myselim, z. Ilir Dizdari dhe z. Fatmir Sula për përkushtimin dhe seriozitetin tyre në edukimin e brezave të ri si dhe për gjallërimin e xhamive me veprimtari të larmishme islame, kulturore dhe edukative.

Gjatë këtij aktiviteti u zhvillua një program me këndime ilahish dhe salavate, konkurs fetar, biseda në mes nxënësve, kojtejl dhe në fund u falë namazi i drekës me xhemat.

XHAMIA E "DY VAJZAVE" NË NJË DOKUMENTAR PLOT DRITË...

Mbrëmjen e së dielës, nëpërmjet valëve të Tv Antena Nord, teleshikuesit patën mundësi të ndiqnin një dokumentar mbi historikun dhe aktivitetin e xhamisë së "Dy Vajzave", që ngrihet sot, mbi vakëfin e Shaban efendisë.

Nëpërmjet shpjegimeve të qarta e plot pathos të imamit të kësaj xhamie, Hoxhë Lavdrim Hamja, teleshikuesi pat mundësi të kuptonte detaje interesante të zhvillimit të vakëfit dhe rrjedhës nëpër të cilën kaloi ndërtimi i xhamisë, si institucion edukativ, ndër shekuj.

Hoxha i nderuar përmendi edhe imamë të shquar që kanë shërbyer në xhaminë e vjetër të këtij vakëfi, si: atdhetari dhe poeti i shquar Sheh Ahmet Shkodra, antikomunisti i flaktë Hafiz Musa Dërguti etj.

Xhamia e "Dy Vajzave", e zbukuroi këtë pjesë të qytetit, që nga viti 2013, kur falë bashkëpunimit të Myftinisë Shkodër me Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam, u realizua ky kompleks me vlerë, i ndërtuar për kujtim të Dy Vajzave, studente kuvajtiane, që humbën jetën në një aksident automobilistik.

Njëri prej prindëve, Ing. Ahmed Esh-Shajia, mori pjesë personalisht në përurimin e kësaj xhamie, ndër më të bukurat në Shkodër.

Myftinia Shkodër shpreh falënderimet e saj për stafin e Tv Antena Nord që realizoi këtë prezantim të bukur e plot dritë të Xhamisë së "Dy Vajzave".

PËRKUJTOHET 27 VJETORI I XHUMASË SË PARË PAS DIKTATURËS KOMUNISTE

Mbrëmjen e së enjtes, më 16 nëntor 2017, Myftinia Shkodër organizoi nje aktivitet përkujtimor, me rastin e ditës historike të 16 nëntorit 1990, kur tek Xhamia e Plumbit, qytetarët e Shkodrës, u tubuan bashkërisht për të mundur frikën dhe diktaturën komuniste, që për 23 vjet me radhë kishte ndaluar me ligj krejt aktivitetin fetar në vend.

Aktiviteti përkujtimor, që sivjet u zhvillua në xhaminë e Tophanës, kishte në qendër të vëmendjes vlerësimin e kësaj date nëpërmjet dëshmive të protagonistëve të saj.

Me shumë vëmendje dhe emocion, të pranishmit ndoqën dëshmitë e të nderuarve, H. Xhelal Sokoli dhe H. Mithat Myftija, të cilët hodhën dritë rreth detajeve të spikatura të atyre ditëve.

Gjatë fjalës së tij, H. Xhelal Sokoli, me gjithë moshën e thyer, tregoi për emocionet e mëdha, sidomos kur në horizontet e masës së panumërt u shfaq Hafiz Sabri Koçi, i veshur Hoxhë, si dhe momenti kur H. Vehbi Dani këndoi ezanin e xhumasë.

Ndërsa H. Mithat Myftija, përtej dëshmive të tij solli në vëmendje realitetin e hidhur të Xhamisë së Plumbit, që megjithëse është monument kulture i klasit të parë, mbetet në gjendje të mjerë.

Aktiviteti mblodhi besimtarë të xhamive, nxënës të Medresesë, imamë të xhamive dhe protagonistë të ditëve të para të rimëkëmbjes, pas një persekutimi të pashembullt.

Më herët, aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, që dha edhe mesazhin e tij me këtë rast.

"Ne jemi të urdhëruar që t'i qendrojmë besnikë fjalës së Zotit (xh.sh), që atë ta shtjellojmë, ta shpjegojmë, ta kumtojmë tek masa e gjerë, ashtu si na ka porositur i Madhi Zot, ashtu si na ka porositur Hz. Muhammedi (a.s), duke mos lejuar askë, që për interesa çfarëdo lloji qofshin, të ndikojë në interpretimin e fjalës së drejtë, jo drejtë dhe jo mirë!

Islami është fé e paqes, është feja e ardhmërisë, është fé e bujarisë, është fé e sinqeritetit, është fé për individin, është fé e familjes, e shoqërisë, fé e cila respekton çdonjërin, pavarësisht se ku jeton, çfarë vepron! E shtrin dorën e bashkëpunimit me të gjithë, në çdo segment të jetës!

Të parët tanë, të nderuar vëllezër e motra, baballarët tanë, gjyshërit tanë, përkundër asaj që kanë vuajtur shumë, në zemrat e tyre kishin një besim të thellë në porositë e të Madhit Zot! Ata, përkundër asaj trysnie dhe asaj dhune të paparë, ata e ruajtën besimin!

Me 16 nëntor 1990, Shkodra u rizgjua, Shkodra e mori veten, u bë simbol i tërë Shqipërisë!"

Mr. Naim Tërnava,

Myfti i Republikës së Kosovës

(Nga hytbeja e xhumasë në xhaminë e Parrucës, më 10 nëntor 2017)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek